

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Kontabiliteti Financiar

P1

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Shënim: Emrat e individëve, vendeve dhe kompanive, të përdorura në këtë provim janë fiktive. Çdo ngjashmëri është plotësisht e rastësishme

Data 27.09.2025

Problemi 1

Elira SH.P.K. është themeluar nga disa të diplomuarish të rinj, me qëllim zhvillimin e aktivitetit tregtar në blerjen dhe shpërndarjen e fasuleve në tregun lokal. Aktualisht, shoqëria është duke aplikuar për financim pranë një banke lokale. Nga informacionet paraprake, është bërë e ditur se, si pjesë e kriterëve të vlerësimit të kualifikimit, banka do të kërkojë paraqitjen e Pasqyrës së Rrjedhës së Parasë.

Në këto rrethana, Elira SH.P.K. ju ka kontaktuar për asistencë në hartimin e Pasqyrës së Rrjedhës së Parasë. Megjithatë, asistenti i kontabilitetit i Elira SH.P.K. ka bërë të ditur se një zjarr ka dëmtuar departamentin e financave dhe si rezultat është siguruar vetëm një kopje e printuar e Pasqyrës së Pozicionit Financiar për dy vitet e fundit në formë të plotë, ndërsa nga Pasqyra e të Ardhurave (Fitim-Humbje) janë ruajtur vetëm të dhëna të pjesshme.

Të dhënat që ju janë paraqitur janë si më poshtë:

Pasqyrë e pjesshme e të ardhurave për vitin që përfundon më 30 Shtator 2023:

	000'€
Fitimi operativ	415
Shpenzimet e interesit	<u>(40)</u>
Fitimi para tatimit	375
Shpenzimet e tatimit	<u>(175)</u>
Fitimi neto i vitit	<u>200</u>

Pasqyrat e pozicionit financiar të Elira SH.P.K. më 30 shtator 2023 dhe 30 shtator 2022 përkatësisht janë dhënë më poshtë.:

	2023	2022
	000'€	000'€
Pasuritë afatgjatë		
Prona, fabrika dhe pajisjet	<u>2,450</u>	<u>1900</u>
Pasuritë afatshkurtër		
Stoqet	450	405
Të arkëtueshmet	430	400
Banka	<u>35</u>	<u>70</u>
Total pasuritë afatshkurtëra	<u>915</u>	<u>875</u>

Total pasuritë	<u>3,365</u>	<u>2,775</u>
Ekuiteti dhe detyrimet		
Kapitali aksionar (1€ për aksion)	650	500
Primi i aksioneve	400	250
Rezerva e rivlerësimit	250	-
Fitimet e mbajtura	<u>1,015</u>	<u>880</u>
Total ekuiteti	<u>2,315</u>	<u>1,630</u>
Detyrimet afatgjata		
Obligacione 10%	250	500
Detyrimet afatshkurtra		
Llogaritë e pagueshme	360	330
Overdrafti bankar	90	65
Tatimet e pagueshme	<u>350</u>	<u>250</u>
Total detyrimet afatshkurtra	<u>800</u>	<u>645</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	<u>3,365</u>	<u>2,775</u>

Janë të rëndësishme të dhënat shtesë si ne vijim:

- (1) Interesi mbi Obligacionet 10% është i pagueshëm në periudha gjysmëvjetore, më 31 Mars dhe 30 Shtator të çdo viti dhe është paguar në datat e skadencës. 50% e obligacionit e pashlyer më 30 Shtator 2022 është shlyer më 30 Shtator 2023.
- (2) Më 1 gusht 2023, pajisja me një kosto prej 500,000 € dhe vlerën neto në libra prej 100,000 € është shitur për 125,000 €.
- (3) Aksionet janë emetuar me para në dorë gjatë vitit që përfundoi më 30 shtator 2023.
- (4) Detajet e pronës, fabrikes dhe pajisjeve në datat e treguara ishin si më poshtë:

	30 Shtator 2023	30 Shtator 2022
	000'€	000'€
Kostoja	3,650	3,000
Zhvlerësimi I akumuluar	<u>(1,200)</u>	<u>(1,100)</u>
Vlera neto në libra	2,450	1,900

(iv) Elira SH.P.K. pagoi dividendë gjatë vitit.

Kërkohe:

(a) Përgatitni Pasqyren e rrjedhës së parave të gatshme për Elira SH.P.K. për vitin që përfundoi më 30 shtator 2023 sipas kerkesave te SNK 7.

(16 pikë)

(b) Shpjegoni katër (4) avantazhe të kontabilitetit të rrjedhës së parasë për përdorues të ndryshëm të informacionit kontabël.

(4 pikë)

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e problemit 1

(a) Pasqyra e rrjedhjes së parave të gatshme të Elira SH.P.K për vitin që përfundoi më 30 shtator 2023

	000'€	000'€
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	375	
Shto shpenzimet e zhvlerësimit (llog.3)	500	
Shto shpenzimet e interesit	40	
Minuso Fitimi nga shitja (llog.4)	(25)	
Ndryshimet në kapitalin qarkullues:		
Rritja e stoqeve (405-450)	(45)	
Rritja e të arkëtueshmeve (400-430)	(30)	
Rritja e të pagueshmeve (330-360)	<u>30</u>	
Paraja e gjeneruar nga operacionet	845	
Interesi I paguar	(40)	
Tatimi I paguar (llog.5)	<u>(75)</u>	
Rrjedhje neto e parasë nga aktivitetet operative		730
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet investive		
Arkëtimet nga shitja e pronës, impiantit dhe pajisjeve	125	
Pagesa për blerjen e pronës, impiantit dhe pajisjeve (llog.2)	<u>(900)</u>	
Rrjedhje neto e parasë nga aktivitetet investive		(775)
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese		
Të ardhurat nga emetimi i aksioneve (1,050 - 750)	300	
Shlyerja e obligacioneve	(250)	
Dividenda e paguar (llog.6)	<u>(65)</u>	
Rrjedhje neto e parasë nga aktivitetet financuese		<u>(15)</u>
Rënie e parasë dhe ekuivalenteve të saj		(60)
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim (70 - 65)		<u>5</u>
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fund (35 - 90)		<u>(55)</u>

Llogaritjet

1) Paraja dhe ekuivalentët e saj	2023	2022
	000'€	000'€
Banka	35	70
Overdrafti bankar	<u>(90)</u>	<u>(65)</u>
Paraja dhe ekuivalentët e saj	(55)	5
Si rezultat, rënia neto e parasë dhe ekuivalentëve të saj është		-60

2)	PIP me kosto	
S` 3,000		
Rivleresimi 250		Shitja 500
Blerja (sh.balancuese) 900		
S`` 3,650		

3)	Zhvleresimi i akumuluar-PIP	
	Shitja 400	S`1,100 Shpenzimet e zhvl. 500
		S``1,200

4) Fitimi ose humbje nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve	000'€
Vlera neto kontabël e asetit të shitur	(100)
Të ardhurat nga shitja	125
Fitim nga shitja	25

5) Tatimi mbi të ardhurat i paguar:	000'€
Gjendja ne fillim	250
Shto ngarkimin në fitim ose humbje	175
Minuso gjendjen ne fund	<u>(350)</u>
Tatimi I paguar	<u>75</u>

6) Dividenta e paguar	000'€
Fitimet e mbajtura ne fillim	880
Shto fitimin e vitit	200
Minuso fitimet e mbajtura ne fund	<u>(1,015)</u>
Dividenta e paguar	<u>65</u>

b) Kater përparësi të kontabilitetit të rrjedhjes së parasë për përdorues të ndryshëm të informacionit kontabël përfshijnë:

- i. Drejton vëmendjen e menaxhmentit ndaj aftësisë së entitetit për të gjeneruar para
- ii. Një mënyrë më gjithëpërfshirëse për të matur performancën dhe për të krahasuar me kompani të tjera ose me të njëjtën kompani nga viti në vit
- iii. Më e thjeshtë për t'u kuptuar dhe për t'u audituar
- iv. Raportimi i rrjedhjes së parasë plotëson më mirë nevojat e përdoruesve të ndryshëm, për shembull, vendimmarrjen nga menaxhmenti; përgjegjësia ndaj aksionerëve dhe auditorëve si dhe punonjësve

Problemi 2

a)

Më 30 Shtator 2016 drejtorët e kompanisë Qielli Shpk kanë mbajtur një takim për të diskutuar rreth disa çështjeve të cilat kishin të bënin me finalizimin e pasqyrave financiare për vitin që kishte përfunduar më 30 Qershor 2016:

(i) Më 3 Korrik kishte rënë një zjarr në depot e kompanisë dhe kishte shkatërruar stoqe të cilat kishin kushtuar 100,000 € dhe kishin vlerë neto të realizueshme 150,000 €.

(ii) Në korrik 2016 Qielli shpk kishte pranuar informatën se klienti më i madh i tyre kishte falimentuar. Më 30 Qershor ky klient i kishte borxh kompanisë tonë 235,000 €, tani pritet që nga ky klient të arkëtohen vetëm nga 10 cent për çdo 1€ që na kishte borxh ky klient.

(iii) Në Korrik 2016 Qielli shpk ka shitur disa stoqe për 75,000 € të cilat stoqe kishin qëndruar në depo për dy vite me radhë. Këto stoqe ishin paraqitur në pasqyrat financiare më 30 Qershor 2016 me kosto në vlerë prej 105,000 €.

(iv) Më 30 Qershor 2016, një punëtoresh kishte rrëshqitur gjatë punës dhe kishte dëmtuar shpinën e saj. Kjo punëtoresh kishte ngritur padi, më 10 Gusht 2016 juristët e kompanisë informuan se ka shumë gjasa që kompania do të gjendet fajtor dhe do të duhet të paguhet 33,000 € punëtoreshes. Punëtoreshja kishte punuar për kompaninë për 4 vite me radhë.

Kërkesa:

Këshilloni Bordin e drejtorëve se si duhet të i trajtojë në kontabilitet këto çështje sipas SNK 37 "Provizionet, detyrimet kontingjente dhe pasuritë kontingjente". Përgjigjen tuaj mbështeteni me arsyet për trajtimin e sugjeruar tuajin.

(10 pikë)

b) Kur Ontexi, një biznes individual, viti financiar i të cilit është më 31 dhjetor çdo vit, ekstraktot një bilanc vërtetues më 31 dhjetor 2016, ai pa se saldo debitore është më e lartë se saldo kreditore për €5,038. Diferenca ishte regjistruar në llogarinë pezull. Diferencat e mëposhtme dolën nga hetimi:

1. Kthimet e blerjeve prej €189 ishin përfshirë në kthimet e shitjeve.
2. Gjatë nënshkrimit të ditarit të çeqeve, pronari kuptoi se ai kishte harruar të regjistrojë pagesën e dy çeqeve prej €125 dhe €249 në lidhje me shpenzimet e elektrike dhe shpenzimet e telefonit.
3. Regjistrimi në lidhje me parapagimet e qirasë prej €500 i ishte debituar llogarisë pezull dhe kredituar në llogarinë e qirasë akruale gabimisht.
4. Makina me vlerë prej €4,600 u prezantua në biznesin e tij dhe regjistrimet e vetme të bëra ishin debitimi në llogarinë e pajisjeve si dhe kontabilizimi për zhvlerësimin. Makinat zhvlerësohen me një normë prej 12.5% të saldosh zbritëse, ndërsa pajisjet zhvlerësohen me një normë prej 10% në vit me metodën lineare. Politika e zhvlerësimit të Ontexi, është zhvlerësimi i plotë në vitin e blerjes.
5. Fatura për dritat dhe nxemjen prej €240 ishte gjetur. Nuk ishte procesuar në konton e shpenzimet mirëpo ishte paraqitur saktë në librin e arkës. Fatura e Ontexi për dritat dhe nxemjen për secilin muaj paguhet automatikisht nga një urdhërpagesë prej llogarisë bankare, në ditën e fundit të secilit muaj.
6. Ontexi kontabilizoi dhe shiti mallra me afat pagese me vlerë prej €1,240 me bazë shitjeje ose kthimi, ku data e fundit e lejuar për kthim për këto mallra ishte 01 shkurt 2017. Sipas SNK 18 këto mallra nuk duhet njohur në të hyrat për vitin 2016, ndërsa ai i kishte regjistruar edhe të hyrat nga shitja edhe koston e mallit të shitur në këto mallra. Këto mallra i kishin kushtuar Ontexit €900.
7. Një rënie në lejimin e borxheve të dyshimta prej €800 ishte debituar në llogarinë e borxheve të këqija dhe kredituar në llogarinë pezull.

Kërkohet:

Përgatitni hyrjet në ditar për Ontexi për regjistrimet dhe/ose përmirësimet, siç është e përshtatshme, transaksionet relevante nga informatat e mësipërme për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016.

(10 pikë)

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja 2

a)

(i) Pasi që zjarri ka rënë në depo dhe I ka shkatërruar stoqet pas fundit të vitit kjo konsiderohet si ngjarje që nuk kërkon korrigjim. Nëse vlera e stoqeve të dëmtuara është material duhet të bëhet shpalosje në pasyra, në të kundërtën nuk ka nevojë as për shpalosje.

(ii) Kjo është një ngjarje e cila kërkon korrigjim pasi që ka të bëjë më të dhëna që është dashur të merren në konsideratë gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare në fund të vitit. Kjo ngjarje duhet të korrigohet si më poshtë

Debi	SHpenzimet e borxheve të këqija (235,000*0.9)	211,500
Kredi	LLogaritë e Arkëtueshme	211,500

(iii) Edhe kjo është ngjarje që kërkon korrigjim pasi që stoqet është dashur të maten me vlerën neto të realizueshme në datën 30 Qershor .

(iv) Poashtu edhe kjo ngjarje kërkon korrigjim të pasqyrave financiare pasi që ngjarja ka ndodhur ende pa u mbyllur vitit ,dhe me gjasë ata do të kompenzojnë punëtoeren me 33,000 €.

Kjo kompani duhet të njoh një provision në pasyrat e veta financiare duke regjistruar:

Debi	SHpenzimet e provizionimit	33,000
Kredi	Provizionet	33,000

b)

Për t'u korrigjuar		
Debi. Llogaria pezull	378	
Kredi. Kthimet e shitjeve		189
Kredi Kthimet e Blerjeve		189

Për t'u korrigjuar		
Debi Shpenzimet elektrike	125	
Debi. Shpenzimet e telefonit	249	
Kredi Paraja e gatshme		374

Për t'u korrigjuar		
Debi Parapagimi i qirasë	500	
Debi Qiraja Akruale	500	
Kredi Llogaria pezull		500
Kredi Shpenzimet e qirasë		500

Për t'u korrigjuar		
Debi. Makina - PFP	4,600	
Debi Llogaria pezull	4,600	
Kredi Paraja e gatshme		4,600
Kredi Pajisjet		4,600
Debi. Shpenzimet e zhvlerësimit	115	
Debi Zhvlerësimi i akumuluar - Pajisjet	460	
Kredi Zhvlerësimi i akumuluar -Makina		575

Për t'u korrigjuar		
Debi. Shpenzimet e dritave & nxemjes	240	
Kredi Llogaria pezull		240

Për t'u korrigjuar		
Debi. Shitjet		1,240
Kredi Të arkëtueshmet tregtare		1,240
Debi. Stoqet në fund		900
Kredi Kosto e shitjes		900

Për t'u korrigjuar		
Debi. Llogaria pezull		800
Kredi. Shpenzimet e borxheve të këqija		800
Debi. Lejimet për b. e d.		800
Kredi. Te hyrat nga b.d		800

Problemi 3

- (a) Në përputhje me kompanitë dhe strukturën e kapitalit të tyre, ekzistojnë mënyra ligjore me anë të të cilave një kompani mund të rrisë kapitalin e saj aksionar.

Kërkohet:

Shpjegoni se çfarë është emetimi bonus dhe çfarë është emetimi i të drejtave, duke deklaruar qartë arsyet, se cili do të ishte i përshtatshëm për t'u marrë në konsideratë nga një entitet që ka plane zgjerimi. **(4 pikë)**

- (b) Bilanci vërtetues i mëposhtëm është përgatitur nga librat kontabël të Harmonia SH.P.K. për datën 31 Mars 2024.

	€	€
Obligacionet 10%		300,000
Toka dhe Ndërtesa (Kostoja e Tokës 90,000€)	390,000	
Zhvlerësimi I akumuluar – Ndërtesat		90,000
Fabrika dhe makinerite (Kostoja 1,044,000€)	787,500	
Mjetet motorike me kosto	420,000	
Zhvlerësimi I akumuluar – Mjetet motorike		170,400
Saldo e humbjeve të akumuluarra më 1 Prill 2023	60,000	
Premia ne aksione		180,600
Stoqet 1 Prill 2023	105,000	
Aksionet (1€)		600,000
Aksione preferenciale të pa-shlyeshme 8% (1€)		210,000
Interesi mbi obligacionet	21,000	
Dividenda e zakonshme e paguar	30,000	
Dividenda e paguar per aksionet preferenciale	8,400	
Të arkëtueshmet dhe të pagueshmet	144,000	81,000
Shitjet		1,038,300
Banka	17,400	
Blerjet	498,300	
Kostoja e shpërndarjes	54,000	
Shpenzimet administrative	134,700	
	<u>2,670,300</u>	<u>2,670,300</u>

Të dhënat shtesë të mëposhtme janë të rëndësishme për vitin në shqyrtim:

- (i) Një mjet motorik, i blerë kater vjet më parë me kosto 48,000€, u shit më 1 Janar 2024 për 21,000€. Arkëtimet nga kjo shitje nuk ishin marrë deri më 31 Mars 2024 dhe transaksioni nuk ishte regjistruar ende në librat kontabël të Harmonia SH.P.K.
- (ii) Zhvlerësimi i pasurive jo qarkulluese duhet të llogaritet kështu:

Mjetet motorike	20% në vit mbi koston
Ndërtesat	5% në vit mbi koston
Fabrika dhe makineritë	10% në vit, me metoden e saldove zbritese

***Zhvlerësimi i ndërtesave dhe mjeteve motorike do të përfshihet te shpenzimet administrative, ndërsa zhvlerësimi i fabrikës dhe makinerive do të përfshihet te kostoja e shitjeve.

Politika e zhvlerësimit e Harmonia SH.P.K. është që të ngarkojë zhvlerësimin e plote në vitin e blerjes dhe asnjë zhvlerësim në vitin e shitjes.

(iii) Toka dhe ndërtesat u rivlerësuan më 31 mars 2024 për 15,000€ shtesë.

(iv) Stoqet ne fund te Harmonia SH.P.K. më 31 mars 2024 u vlerësuan në 153,000 €.

(v) Më 1 tetor 2023, Harmonia SH.P.K. bëri një emetim të drejtash prej 3 për çdo 2 aksione kapitali me një çmim prej 5 € për aksion. Ky emetim nuk ishte regjistruar ende në librat e Harmonia SH.P.K.

(vi) Dividendët shtesë përfundimtare jane deklaruar më 20 mars 2024 për të gjitha aksionet në zoterim në kete datë si më poshtë:

Dividendët e zakonshëm përfundimtarë me 5%.
Gjysma e dividenteve preferenciale me 8%

(vii) Tatimet e korporatës për vitin ishin vlerësuar në 54,000 €.

Kërkohe:

(1) Përgatitni Pasqyren e te ardhurave gjithëpërfshirëse të Harmonia SH.P.K. për vitin që përfundoi më 31 Mars 2024. **(11 pikë)**

(2) Përgatitni Pasqyren e ndryshimeve ne ekuitet për vitin që përfundon më 31 Mars 2024 për Harmonia SH.P.K. **(5 pikë)**

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja 3

- (a) Emetimi i bonuseve është një lëshim aksionesh për aksionerët ekzistues pa pagesë, dmth ata nuk paguajnë për aksionet dhe aksionet lëshohen në proporcion me mbajtjen e tyre ekzistuese. Kjo është thjesht një mënyrë për entitetin të kapitalizojë rezervat e tij dhe të rrisë numrin e aksioneve të lëshuara.

Një emetim i të drejtave është një ofertë nga entiteti për të lëshuar aksione për aksionerët aktualë në bazë proporcionali me mbajtjen e tyre ekzistuese. Emisionet e të drejtave bëhen në një çmim më të ulët se vlera e tregut.

Një entitet që ka plane zgjerimi duhet të bëjë një emetim të të drejtave, pasi ai mbledh para për entitetin, ndërsa emetimi i bonuseve nuk do të sigurojë paratë e nevojshme për zgjerim.

(i) Harmonia SH.P.K.
Pasqyra e Të Ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin që mbaron më 31 Mars 2024
'€'

Shitjet	1,038,300
Minuso kostoja e shitjes (LL1)	<u>(529,050)</u>
Fitimi bruto	509,250
Fitimi kapital (LL3)	1,800
Shpenzimet administrative (LL2)	(224,100)
Kostoja e shperndarjes	<u>(54,000)</u>
Fitimi operativ	232,950
Shpenzimet e interesit ne obligacione	<u>(30,000)</u>
	202,950
Shpenzimet e tatimit	<u>(54,000)</u>
Fitimi neto i vitit	148,950

(ii) Pasqyra e ndryshimeve në kapital të Harmonia SH.P.K. për vitin që përfundoi më 31 Mars 2024

	Kapitali aksionar preferencial '€'	Kapitali aksionar i zakonshem '€'	Primi i aksioneve '€'	Rezerva e rivlerësimit '€'	Fitimet e mbajtura '€'
Gjendja ne fillim	210,000	600,000	180,600		(60,000)
Emetimi i aksioneve		900,000	3,600,000		
Rivleresimi				15,000	148,950
Pagesa e dividendes					<u>(121,800)*</u>
Gjendja ne fund	<u>210,000</u>	<u>1,500,000</u>	<u>3,780,600</u>	<u>15,000</u>	<u>(32,850)</u>

*Dividenta total: Dividenta e zakonshme e paguar 30,000

Dividenta e paguar per aksionet preferenciale 8,400

Dividenta e zakonshme shtese=5%*1,500,000= 75,000

Dividenta preferenciale shtese=8%/2*210,000= 8,400

Total 121,800

LL1

$$\text{KMSH} = 105,000 + 498,300 - 153,000 = 450,300$$

$$\text{Zhvlresimi I fabrikes dhe makinerive} = 10\% * \text{VNL} = 10\% * 787,500 = 78,500$$

$$\text{Total kosto e shitjes} = 529,050$$

LL2

$$\text{Shpenzimet administrative sipas pyetjes: } 134,700$$

$$\text{Zhvl ndertesa} = 300,000 * 5\% = 15,000$$

$$\text{Zhvl mjete motorike} = 20\% * (420,000 - 48,000) = 20\% * 372,000 = 74,400$$

$$\text{Total Shpenzimet administrative } 224,100$$

LL3

$$\text{Zhvl vjetor i mjetit motorik te shitur} = 20\% * 48,000 = 9,600$$

$$\text{Zhvl I akumuluar i mjetit motorik te shitur} = 3 \text{ vite (ne vitin e shitjes nuk ndahet zhvlresim)} * 9,600 = 28,800$$

$$\text{VNL} = 48,000 - 28,800 = 19,200$$

$$\text{Cmimi shites } \underline{\hspace{10em}} 21,000$$

$$\text{Fitimi kapital } \hspace{10em} 1,800$$

Problemi 4

Pjesa a)

Blerta shpk bleu një ndërtesë që kushton 500,000 € në 1 janar 2010 me një jetë të dobishme pesëdhjetë vjet. Ndërtesa ka një vlerë të mbetur prej 100,000 €. Në 31 dhjetor 2016, ndërtesa ishte rivlerësuar në 559,000 € sipas vlerës së tregut. Në këtë datë, nuk pati ndonjë ndryshim në jetën e dobishme të ndërtesës, por vlera e mbetur e vlerësuar ishte zero. Më 31 dhjetor 2018, ndërtesa u shit për 600,000 €.

Kërkohet:

- i) Bëni regjistrimet e duhura në kontabilitet për të regjistruar rivlerësimin më 31/12/2016
- ii) Bëni regjistrimet e duhura në kontabilitet për të regjistruar shitjen më 31/12/2018
10 pikë)

Pjesa b)

Draft pasqyrat financiare të BESI shpk më 30 Shtator 2019 janë përgatitur, mirëpo ka mbetur një diference në vlerë prej € 6,100, e cila përkohësisht është përfshirë si *kredi* në llogarinë pezull të bilancit të gjendjes së kompanisë.

Gjatë kontrollimeve janë gjetur gabimet si në vijim:

- (1) €6,500 ishin paguar për shpenzimet e mirëmbajtjes së objekteve; në librin e arkës kjo pagesë ishte regjistruar saktë dhe ishte debituar llogaria e objekteve si pasuri në vlerë prej €5,600.
- (2) Një makinë ishte shkatërruar dhe për te ishte pranuar një çek në vlerë prej €7,000 për mbeturinat e makinës në një aksident i cili ishte regjistruar si duhet në librin e arkës mirëpo nuk ishte bërë asnjë regjistrim tjetër. Makina kishte një kosto prej €55,000 dhe zhvlerësim të akumuluar në vlerë prej €8,000. Zhvlerësimi ishte regjistruar si duhet për vitin që mbaron më 30 Shtator 2019, duke e bërë zhvlerësimin e akumuluar të makinave në atë datë €15,000. Ende asnjë regjistrim nuk ishte bërë që të eliminohet kostoja dhe zhvlerësimi i akumuluar i makinës.

Është politikë e kompanisë të mos aplikojë/ngarkojë zhvlerësim për pasuri në vitin e largimit (hedhjes).

Shënim: Pjesa a) dhe pjesa b) e detyrës janë kompani të ndryshme, andaj nuk janë të ndërlidhura.

Kërkohe:

Përgatitni regjistrimet në ditar, për të korrigjuar gabimet, për të regjistruar humbjen në makinë dhe për të pastruar llogarinë pezull(10 pikë)

[Totali: 20 Pikë]

Zgjidhja e problemit 4

a)
$$\text{Zhvlerësimi vjetor} = \frac{500,000 - 100,000}{50 \text{ vite}} = 8,000$$

Zhvlerësimi i akumuluar = 7 vite x 8,000 = 56,000

VNL = 500,000 - 56,000 = 444,000

Vlera e tregut 559,000

Rezerva e rivlerësimit 115,000

Regjistrimet më 31/12/2016

D Ndërtesa	59,000	
D Zhvlerësimi i akumuluar	56,000	
	K Rezerva e rivlerësimit	115,000

31/12/2018

Zhvlerësimi i ri vjetor = $\frac{559,000 - 0}{43 \text{ vite}} = 13,000$

50 vite - 7 vite = 43 vite

Zhvlerësimi i akumuluar për 2017 dhe 2018 = 2 vite x 13,000 = 26,000

VNL më 31/12/2018 = 559,000 - 26,000 = 533,000

Fitimi kapital = 600,000 - 533,000 = 67,000

Regjistrimet më 31/12/2018

D: Paraja e gatshme	600,000	
D Zhvlerësimi i akumuluar	26,000	
	K Ndërtesa-Kosto	559,000
	K Fitimi kapital	67,000

Pjesa b)

1)

D: Shpenzimet e mirëmbajtjes	6,500	
	K: Objektet-Pasuri	5,600
	K: Llogaria pezull	900

Korrigjimi i gabimit në postimin e kostos së mirëmbajtjes të objekteve

2)

D: Llogaria pezull	7,000	
D: Humbja	40,000	
D: Zhvlerësimi i akumuluar-Makina	8,000	
	K: Makina-kosto	55,000

Llogaria Pezull

Saldo në fillim 6,100

Saldo e/b	<u>7,000</u>	<u>900</u>
	0	Saldo në fund 0

Problemi 5

Jeta sh.p.k ka blerë 75% të aksioneve të kompanisë Petriti sh.p.k më 1 janar 2017. Pasqyrat financiare të të ardhurave të kompanive për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017 janë si në vijim:

	Jeta shpk	Petriti shpk
	€m	€m
Të hyrat	7,500	3,000
KMSH	<u>4,000</u>	<u>1,600</u>
Fitimi bruto	3,500	1,400
Shpenzimet operative	2,000	500
Fitimi para tatimit	1,500	900
Tatimi	300	120
Fitimi neto për vitin	1,200	780

Gjatë vitit, Jeta shpk i ka shitur mallra Petritit për €5m, të cilat kishin kosto prej €3m . Në fund të vitit, 50% e këtyre mallrave kishin mbetur në stoqet e Petriti sh.p.k.

Kërkohe:

(a) Përgatitni pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave për grupin Jeta për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017.

(15 pikë)

(b) Gjeni sa është fitimi që ju takon mbajtësve të ekuitetit të kompanisë mëmë. (5 pikë)

Zgjidhja e problemit 5

Grupi Jeta

Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017

	€m
Të hyrat (7,500 + 3,000 - 5)	10,495
KMSH (4,000 + 1,600 - 5 + 1)	5,596
Fitimi bruto	4,899
Shpenzimet operative (2,000 + 500)	<u>2,500</u>
Fitimi para tatimit	2,399
Shpenzimet e tatimit (300 + 120)	<u>420</u>
Fitimi neto i vitit	<u>1,979</u>

Tregtia ndërgrupore

Çmimi shitës	<u>5</u>
Kosto	<u>3</u>
Fitimi bruto	<u>2</u>
Fitimi i porealizuar $50\% \times 2m = 1m$	

(b) Fitimi i ndarë për :

*Mbajtësit e ekuitetit të kompanisë mëmë (shifër balancuese)	1,784.00
**Interesi jo-kontrollues ($25\% \times 780$)	195.00
	<u>1,979.00</u>

* $1,784 = 1,200$ fitimi i mëmës + ($75\% \times 780$ e fitimit të filialës) - 1 (fitimi i porealizuar nga shitja e bërë nga mëma për filialen).

** Sqarimi në lidhje me mos korigjim për fitim të porealizuar për IJK:

Veni re që korigjimet e IJK-së ndodhin vetëm kur shitja bëhet nga filiala - kompanisë mëmë (kur fitimi i porealizuar është tek filiala). Nëse shitja bëhet nga kompania mëmë - filialës, aty nuk do të ketë korigjime të IJK-së.

Meqenëse Jeta shpk (mëma) i ka shitur Petritit shpk (filiala) atëherë nuk duhet korigjuar IJK.